

FJALA E DEPUTETES SHPRESA MARNOJ

E ENJTE 12 MAJ 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot në këtë pike të rendit të ditës kemi shqyrtimin e një projektligji mjaft të rëndësishëm për sa i përket targetit, që i referohet në përgjithësi, por edhe asaj që parashikohet të arrihet përmes tij. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për një hua të bazuar në politika për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, ku si qellim kryesor është përmirësimi i kuadrit të politikave dhe legjislacionit për akses të barabartë ligjor në vendin tonë.

Kjo marrëveshje, e nënshkruar në nëntor të vitit 2021, synon marrjen e një huaje prej 50 milionë eurosh nga Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD) në formën e mbështetjes buxhetore, e cila do të plotësojë nevojat për financim të buxhetit të shtetit dhe do të përdoret për financimin e programit të politikave për mbështetjen e barazisë gjinore në aksesin ndaj mundësive ekonomike në Shqipëri. Në fakt, përpjekjet e qeverisë shqiptare, në bashkëpunim me agjenci apo fondacione të ndryshme, përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor për ta rritur dhe për ta forcuar sa më shumë përfaqësimin dhe rolin e gruas jo vetëm në politikë, por edhe në vendimmarrje, në ekonomi dhe në shoqëri në tërësi kanë qenë prej vitesh prioritet, duke rritur në mënyrë të konsiderueshme numrin e programeve të ndryshme buxhetore që shkojnë për mbështetjen e barazisë gjinore.

Më konkretisht, 3 janë objektivat kryesorë të këtij programi mbështetës, ku secili prej tyre parashikon kryerjen e disa reformave: Objektivi i parë është përmirësimi i aksesit të grave tek asetet, ku noterët duhet të mbrojnë të drejtat e pronësisë së grave në procesin e transferimit ose trashëgimit të pasurive të paluajtshme të krijuara gjatë martesës. Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të punojë për regjistrimin e bashkëpronareve gra në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Strukturat shtetërore duhet të nxjerrin e të zbatojnë aktet për financimin e ofruesve të ndihmës juridike. Objektivi i dytë është rritja

e mundësive të tregut të punës për gratë, ku autoriteti i prokurimit publik të punojë për respektimin e parimit të barazisë gjinore nga subjektet që marrin pjesë në tenderët publikë.

Strukturat shtetërore duhet të punojnë për të përmirësuar cilësinë dhe disponueshmërisë e arsimit parashkollor dhe fillor dhe të krijoje mundësi që gratë me fëmijë të hyjnë në tregun e punës. Gjithashtu, duhet të përmirësohet ofrimi i shërbimeve të punësimit për anëtarët e grupeve me delikate apo të riskuara, siç janë vajzat e reja, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, pakicat etnike apo edhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe duhet të mbështeten me subvencione shërbimet e përkujdesjes së fëmijëve, për t'i zgjeruar mundësitë e tregut të punës për gratë dhe vajzat.

Objektivi i tretë është forcimi i masave institucionale për mbështetjen e politikave gjinore, ku, konkretisht, kemi: monitorimin nga qeveritë vendore të shpenzimeve publike të lidhura me gjininë; integrimin dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në sistemin e informacionit të menaxhimit financiar shqiptar për t'i monitoruar më mirë politikat dhe programet në lidhje me gjininë, si dhe përgatitjen e indeksit të barazisë gjinore të harmonizuar me Institutin Europian për Barazi Gjinore. Programi i parashikuar në këtë marrëveshje mbështetet në kuadrin e politikave dhe legjislacionit ekzistues, si: në programin e qeverisë, i cili parashikon mbështetje për njerëzit që kanë më shumë nevojë, rritje të aksesit për punësim, riintegrim social, shërbim shëndetësor më të mirë, të aksesueshëm dhe të sigurt; në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, e cila planifikon politika nxitëse për punësimin dhe formimin profesional për të gjithë njerëzit, politika të nxitjes së arsimit dhe të kohezionit social dhe reforma në kuadër të barazisë gjinore, si dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe planin e saj të veprimit që parashikon një sërë reformash në drejtim të barazisë gjinore.

Marrëveshja, gjithashtu, lidhet drejtpërdrejt edhe me disa nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat u specifikuan nga ministrja, konkretisht, objektivat 5 dhe 8, që janë fuqizimi i të gjitha grave e vajzave dhe nxitja e rritjes së vazhdueshme ekonomike, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë, produktiv dhe të denjë për të gjithë. Kjo marrëveshje ka terma të favorshëm të huas, krahasuar me kushtet e tregut, si më poshtë: shuma e huas është 50 milionë euro; interesi, bazuar në normën e referencës Euribor plus marzhin, është 1,35%; tarifa e angazhimit është 0,25% mbi vlerën e huas së disponueshme; tarifa e vlerësimit është 0,75% e vlerës totale të huas, jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes; maturimi është 12 vjet, nga të cilat, 3 vjet pa pagesë principali. Theksoj se kjo marrëveshje parashikon edhe monitorimin e zbatimit të programit, i cili do të kryhet dy herë në

vit nga Agjencia Franceze për Zhvillim dhe ky monitorim dhe vlerësim i kryer nga Agjencia do të përbejë bazën për disbursimin e huas.

E theksoj këtë pikë, sepse ky aspekt gjithmonë ka debat, pra se si do të vazhdojë ky program, sa transparent do të jetë, sa i sigurt, si do të ndiqet e me radhë. Në fakt, ky projektligj është shoqëruar me debate edhe në komisionet e tjera për dhënie mendimi, si në Komisionin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. E theksoj se kjo agjenci, do të mbikëqyrë zbatimin e reformave të parashikuara në program, të cilat do të jenë në thelb parakushte për akordimin e kësaj mbështetje buxhetore.

Për ta mbyllur, unë ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë këtë projektligj, dhe kam besim se edhe kolegët e opozitës, sidomos koleget, do ta miratojnë atë, sepse, nëse ka diçka përtej pikëpamjeve politike, ajo është mbështetja e pakursyer dhe pa kushte që duhet t'i japim njëratjetrës si gra, por edhe grave në përgjithësi. Faleminderit!